


BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32
A 58



MURAT ALIAJ
KARROCA

- NOVELE -

891.985-32

854-32

258

MURAT ALIAJ

KARROCA

(Novelë)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: Sokol Jakova
Kopertina nga: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 6.000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204 - 72

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

I.

Xha Fotua ishte ulur në mes të shkallëve dhe po vështron te karrocën. Freri me pajimet e tjera kishin shkarë nga varsja e murit dhe kishin rënë përtokë. Ai i shikonte dhe s'i bënte zemra të luan-te nga vendi.

Kopshti i vogël, që ndodhej përpara shtëpisë, shkëlgente nga pastërtia. Gjethet dhe degët e tha-ta ishin mbledhur me kujdes në një qoshe. Pemët e vogla, që ishin mbjellë disa vjet më parë rrëth kopshtit, kishin lidhur kokrra. Çdo gjë dukej e bukur. I shihte të gjitha me radhë xha Fotua, por asgjë nuk mund t'ja mbushte atë bosh-llek, që e bënte të mendohej gjaçë. Kishte rënë në hall me atë karrocë, që rrinte e fshehur aty, pranë murit të kopshtit...

Atë ditë xha Fotua i kishte matur rrugët e qytetit me hap më mirë se gjeometrat. Karrocat që ndeshite në rrugë e sipër, i shikonte me po atë kujdes, si shikon klienti mallin që do të blejë, derisa i zhdukeshin nga sytë. Ai nuk kishte ndër mend të blente karrocë, bile do të ishte fitore sikur të gjente një myshteri për ta hequr qafe

atë gërdallë, që, me sa dukej, do t'i kalbeshin dërrasat atje nën hijen e murit të kopshtit, ku shkundte pareshtur gjethë të verdha një kumbull, që çdo vit i krimbte kokrrat. Para tij kalonin aq shumë karroca, sa nuk mund t'i ndiqte të gjitha. Xha Fotua ecte ngadalë trotuarit dhe të gjitha karrocat i shihte me të njëjtin sy.

Sa herë që kthehej në shtëpi pas këtyre shetitjeve të mërzitshme, xha Fotua ju afrohej të dy kuajve, i kapte pér jelesh dhe, pasi i përkëdhelte një copë herë, niste të qante hallin me ta:

— Hë, si thoni ju, kur do të na bëhet mbarë të shetisim përsëri qytetit?

Por kuajt, që kishin kohë pa u mbërthyer në karrocë, tundnin kokën fort, sikur të mos jua kishte qejfi ato përkëdhelje. Me sa dukej, ju pëlhente më tepér rehatia.

— Hë... S'ju pëlqen, ë? — shfrynte pastaj gjithë inat xha Fotua. — E di unë pse ma tundni kështu kokën ju; veç dijeni se, po dolëm, shkumë kam pér t'ju nxjerrë. Kafshë mosmirënjohe!

Pastaj futej në kuzhinë, ulej në minderin pranë sobës dhe mbushte me duhan çibukun e madh, që i ishin djegur anët nga nxehtësia. Pér karrocën nuk kishte biseduar me asnjeri, se e dinte që askush nuk mund të thoshte ndonjë gjë të re, veç atyre që i kishte dëgjuar me dhjetëra herë. Vetëm e bija çoku i binte në qafë nganjéherë si me shaka. Megjithatë, çdo gjë kalonte si pa u vënë re dhe xha Fotua, duke ndjekur shtëllungat e dendura të tymit, që ngriheshin lart nga çibuku, mendonte se ç'do të bënte të nesërmen.

Kohët e fundit xha Fotua kishte ndryshuar shumë. Në shtëpi çdo gjë i dukej e vrazhdë dhe e mërzitshme. Zbatica po vazhdonte aq gjatë, sa ai po e humbiste durimin. Kishte qejf të takonte ndonjë nga shokët e dikurshëm, të bisedonte e të qante hallet me të, por, si për çudi, nuk i kishte dalë asnjeri përpara. Kështu që atij i mbetej vetëm të qante hallet me vete dhe të grindej me fëmijët, sa herë që e bezdisnin. I biri, i cili vazhdonte shkollën, çdo ditë endej sa andej-këtej me ndonjë libër në xhep, si për t'u gjendur në punë. Xha Fotos se si i vinte kur e shihë tek endesh kot pa punë. Le të tjerat, por kishte dhe gojë e thoshte se ishte i zënë deri në grykë me mësimë. E shoqja, s'dinte gjë tjetër, veç të ankohej gjithmonë nga ajo e shkretë reumatizëm që nuk harronte t'i dërgonte nganjëherë ndonjë krizë të fortë. Më tepër nga të gjithë e mërziste e bija me atë radio, që e hapte pothuaj çdo mbrëmje. E ku ishte ai për muzikë ato ditë! Por ja që askush nuk donte t'ja dinte. Në atë shtëpi çdo gjë kalonte e qetë, si disa kohë më parë, edhe pse xha Fotos i dukej sikur përpara tij kishte vërvshuar një det plot dallgë, në të cilin e kishte vështirë të mbahej diku për të shpëtuar veten...

— Hej, baba, ç'ke që ke humbur kaq thellë në mendime? — e pyeti i biri tek po dilte nga shtëpia.

— Ik, mor zullap, se s'janë për ty këto punë, — ja priti xha Fotua tërë inat.

Pasi u largua ai, u hap përsëri dera e kuzhinës prej nga doli Zana. Fytyra e menduar e të atit i bëri përshtypje.

— Ç'ke kështu, baba? — e pyeti.

Xha Fotua nuk ju përgjegj, veçse u ngrit nga vendi dhe bëri të hynte në kuzhinë.

— Baba, — e ndali Zana, — më duket sikur diçka nuk të vete mirë, përse s'na thua të të ndihmojmë.

— Gjepura, bijë, gjepura!

— Nuk më duken gjepura, baba! Mos është puna e karrocës që të bën kaq të menduar?

Xha Foton sikur e shpuan me gjilpëra kur dëgjoi fjalën «karrocë». E shikonte të bijën me sy dhe nuk dinte si ta kuptonte shqetësimin e saj. Ç'ishin këto rrufe të papritura që po i vinin prej të bijve!

— Po mirë, moj bijë, po ti pse ma zë në gojë karrocën?

— Ta zë, baba, se ja kam shumë frikën. Kjo karrocë do të na sjellë telashe të mëdha më vonë.

— E nga e more vesh ti këtë?

— Kjo gjë duket, baba. Po të ishte puna jote në vijë, karroca nuk do kishte mbetur aty, në hije të kumbullës.

— Këtë mos ma thuaj më, Zana. More vesh? Nuk dua të dëgjoj më. Ik tani në punën tënde.

Zana nuk mendoi se i ati do t'ja priste aq shkurt. Deshte ta niste përsëri diskutimin me të, por ai s'priti më. Hyri në kuzhinë për të mbushur çibukun me duhan. Zana mbeti vetëm aty, në mes të shkallëve, duke shikuar karrocën. Se si i vinte kur e shihte aty, nën hijen e kumbullës! Karroca ishte e vetmja gjë që e mbante xha Foton të lidhur aq ngushtë me të kaluarën. Në zemrën e të atit duhej hyrë qetë, fare qetë, pa cënuar këtu dashurinë që ai kishte për të. Ndaj Zana vriste

mendjen se si mund ta bënte këtë. Nuk ishte aq e thjeshtë, por ishte e domosdoshme.

Rrugën për në uzinë ajo pothuaj nuk e ndjeu fare, jo se autobuzi ecte shpejt, por sepse mendja nuk i hiqej nga fytyra e menduar e të atit. Nuk i besohej kurrë që dashuria e tij për karrocën të ishte aq e madhe, megjithëse mendja i thoshte se në këtë dashuri kishte më tepër kapriçio sesa ndjenjë. Vetëm kur zbriti në stacion dhe ndjeu t'i vrasë veshin zhurma e fortë që bëhej në repartet e uzinës, e pa të domosdoshme të shkëputej nga ato që mendonte rrugës e që i sillnin aq shumë shqetësimë. Sheshi përpara portave të mëdha të uzinës ushtoi nga zërat e fortë të punëtorëve, që sa kishin zbritur nga autobuzi. Ajo nxitoi hapin dhe, ashtu e vetmuar siç ishte nisur nga shtëpia, u drejtua për në repart. As vetë nuk po e kuptonte pse ja kishte qejfi aq shumë vetminë në ato çaste. Ndoshta sepse kështu bisedonte më lirshëm me veten.

Befas një zë e thirri nga prapa. S'i ndahej që s'i ndahej dhe ky Iliri. Zana ngadalësoi hapin për ta pritur. E dinte se ai do të niste me ato shakatë e tij të zakonshme dhe ajo do të mërzitej e s'do ta dëgjonte dot. Zana gjithmonë qëndronte serioze përpara shakave të Ilirit, aq sa i dukej sikur e kishte tepruar. Ajo e dinte mirë se Iliri nuk kishte djallëzi në shakatë e tij, por asaj nuk i pëlqenin ato.

— Si shumë hollë paske ardhur sot. Netët e pranverës janë ende të freskëta, — e ngacmoi Iliri. — Tani në pranverë mund të të ngjitet një

rrufë e thatë. Po të jesh kurioze të dish më tepër për rrufën, jam gati të të tregoj shkurtimisht shenjat nga e dallojmë se është rrufë me burim ftohje dhe jo grip.

— Për këtë mos u mundo, Ilir, pasi mbrëmë foli doktori në radio një orë të tërë.

— Jo, më vjen shumë keq, Zana! Unë nuk e quaj mundim po të të përsëris edhe një herë ato që tha doktori mbrëmë në radio.

— Ilir, këshillat e tua duhen regjistruar në një blok, që të mos venë dëm.

— Unë ta kam thënë prej kohësh këtë. Megjithatë jam i kënaqur që më së fundi e ndjeve frikën e rrufës.

Sakaq arritën në repart.

Orët e para Zana i kaloi mirë. Më vonë u dukën lëvizjet e para të presionit të pompës. Zana thirri menjëherë në telefon Ilirin. S'vonoi shumë dhe ai, me dy çelësa në xhep, u gjend pranë pompës që kishte difekt.

— Hë, Zana, ç'ka për «urgjencën»?

— Ja, shihe. Presioni lëviz shumë, kurse sasia e lëndës ka rënje.

— Ka kohë kështu?

Zana vuri buzën në gaz se ju kujtua doktori që, para çdo vizite, të bën këtë pyetje: «Sa kohë ke që je sëmurë»?

— Sa kohë ka, po të pyes? — nguli këmbë Iliri.

— Unë tani e vura re. Edhe Kosta, që më dorëzoi turnin, nuk më tha gjë për të.

— Atëherë s'do të ketë gjë me rëndësi. Zana prapë qeshi.